



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:177065
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05579460

Rev.nr.156/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Milena Gjeriq dhe Rustem Thaqi, anëtar, në çështjen kontestimore të paditësit L. Th. nga P., kundër të paditurës Posta Telekomunikacioni P., të cilën e përfaqëson G. L. me autorizim në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.6382/2020, të datës 12.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës Posta Telekomunikacioni i Kosovës, me seli në P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.6382/2020, të datës 12.12.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.971/2019, 11.11.2020, është vendosur që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit L. Th. nga P., si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi nr....., i datës 07.03.2012 dhe detyrohet e paditura, Posta Telekomunikacioni i Kosovës në P., që paditësit t'ia paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 10 dhe 9, për 43 muaj dhe atë për periudhën kohore prej datës 01.02.2012, gjer me datë 01.09.2015, kur edhe është lidhur kontrata e re, t'ia paguaj paditësit për bruto pagës-diferencën më pak të paguar shumë prej 5,326.56 €, nga e cila shumë do ti ndalet kontributi pensional në shumë prej 266.33 €, dhe tatimi në burim në shumë prej 506.02 € me kamat ligjore

duke filluar nga data 16.10.2020, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 150.00 €, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur me aktgjykimin Ac.nr.6382/2020, të datës 12.12.2023, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurës, Posta Telekomunikacioni i Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.971/2019 të datës 11.11.2020, e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor e paditura ka paraqitur revizion , për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet ose të prishen të dy aktgjykimet dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimin të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK –së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, L. Th. nga P., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni P. me dt. 12.04.2013, ka ushtruar padi për anulimin e vendimit, dhe kompensimin e diferencës së pagës në mes të gradës 9 dhe 10, si në kërkesëpadi. Gjykata e shkallës së parë, fillimisht me aktgjykimin C.nr. 307/13, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Mirëpo aktgjykimi në fjalë sipas ankesës së të paditurës, me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.2642/16, datë 31.07.2019, është prishur me vërejtjet se dispozitivi është i paqartë meqë gjykata e çështjes nuk ka përcaktuar lartësinë e ndryshimit të pagës, bonusit dhe trustit në mes gradës 10 dhe 9. Prandaj, lënda është kthyer në rigjykim në mënyrë që të konstatohet se a është kontestuese mes palëve ndërgjyqëse lartësia e kërkesëpadiës, e sipas nevojës, lartësia e kërkesëpadiës të vërtetohet me ekspertizë financiare.

Në procedurën e rigjykimin, gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, në seancën e shqyrtimit kryesor, si provë materiale administroi ekspertizën financiare, të hartuar më datë 16.10.2020, nga eksperti gjyqësor U. S., kontratën e punës nr. ..., datë 20.10.2011, aktvendimin e të paditurës me nr. ..., datë 07.03.2012, si dhe ankesën e paditësit, të parashtruar te e paditura më datë 225.02.2013. Pasi që gjykata bëri vlerësimin e provave me

kujdes, u vërtetua se paditësi L. Th. nga P., ka themeluar marrëdhënie të punës me të paditurën, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës - PTK-sha, P., në vendin e punës Udhëheqës Ekipi për Energjetikë, në njësinë Telekomu i Kosovës në lokacionin në P.. Sipas nenit 5 të kësaj kontrate të punësuarit, këtu paditësit L. Th., i caktohet paga bazë për punën që e kryen për punëdhënësin, në lartësi të gradës 10. E paditura me aktvendimin nr. ... të datës 07.03.2012, paditësit i cakton të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 9, sipas strukturës së gradave, duke i ulur paditësit gradën e të ardhurave personale nga grada 10 në gradën 9. Gjykata duke vendosur lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me të cilin vendim, paditësit i është ulur grada e të ardhurave personale, duke u mbështetur në dispozitat e neni 10.1,2, pika 2. 1, 10.3, 10.5, 11, 55, 56 të Ligjit të Punës me Nr. 03/L-2012, e lidhur me nenin 5 të kontratës së punës të datës 20.10.2011, erdhi në përfundim se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës, andaj nga këto arsye kërkesëpadinë e paditësit e aprovoi si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur me lartësinë kërkesëpadisë së paditësit, gjykata vendimin e mbështeti në ekspertizën e ekspertit financiar U. S., të cilës provë gjykata ia fali besimin dhe në bazë të cilës i përcaktoi shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara në ankesë. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i mirë arsyetuar. Në aktgjykim janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga të cilët është vërtetuar themelësia dhe lartësia e kërkesëpadisë, dhe si i tillë aktgjykimi në tërësi i përmbush kërkesat ligjore që dalin nga neni 160 i LPK-së.

Sipas Gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë, me kujdes i ka çmuar të gjitha provat e propozuara nga ndërgjyqesit, duke konstatuar drejtë se me kontratën nr. ..., të dt. 20.10.2011, paditësit L. Th. nga P., për vendin e punës, i caktohet paga bazë në lartësi të gradës së 10, ndërsa sipas aktvendimit ... të datës 07.03.2012, paditësit, kundër vullnetit të tij, përkatësisht në kundërshtim me kontratën e punës, i caktohen të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 9 sipas strukturës së gradave.

Gjykata e Apelit nuk e pranon si të mbështetur pretendimin e palës së paditur se vendimi për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale ka mbështetje në vendimin e aksionarit – MZHE (Ministritë për Zhvillim Ekonomik), për faktin se nga përmbajtja e vendimit të referuar, rezulton se i njëjti ka karakter rekomandues për të paditurën, në drejtim të uljes së shpenzimeve

në PTK, - në raport me të hyrat e përgjithshme. Meqenëse, gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, në gjykatën e shkallës së parë e paditura nuk ka dëshmuar se kishte miratuar ndonjë plan për zbatimin e rekomandimeve të aksionarit MZHE-së, apo që për vendet përkatëse të punës të ketë nxjerrë rregullore për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale, prandaj ky pretendim vlerësohet si i pambështetur dhe pa ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe përkitazi me ankesën e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka pranuar si të bazuar padinë e paditësit. Kjo Gjykatë, vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës ma të ultë, sipas të cilit është aprovuar kërkesëpapia e paditësit, pasi që gjykata e shkallës së parë me pa mëdyshje ka vërtetuar se paditësi në bazë të kontratës së punës lidhur me të paditurën ka pas gradën e të ardhurave personale 10, në bazë të nenit 5 të kësaj kontrate dhe se në mënyre arbitrare pa pëlqimin e paditësit kjo është ndryshuar, duke e zvogëluar pagën e paditësit përkundër kontratës ekzistuese.

U refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet tjera të revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika (n) LPK. Gjykata e revizionit vlerëson se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit, andaj këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pa bazuara.

Edhe sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, e drejta materiale është aplikuar në mënyrë drejtë në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese. Sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 10 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e Ministrisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me ligjshmërinë e Aktvendimit të Bordit të drejtorëve të paditurës nr..... të datës 7 mars 2012, por Gjykata e Revizionit gjeti se lidhur me këtë janë dhënë shpjegimet e duhura nga ana gjykatave të instancës më të ulët. Sipas kontratës së punës paga është përcaktuar sipas gradës 10 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të bordit të drejtorëve të paditurës sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e ministrisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur të paraqet një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur për çfarë arsyeje pretendimet ankimore janë të pabazuara. Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menagjues. Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale përkatësisht dispozitën e nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës me të cilin është përcaktuar se i punësuar ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit. Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar, përveç tjerave, edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Lidhur me pretendimet e revizionit se në raste të ngjashme, kolegjet e Gjykatës së Apelit kanë vendosur ndryshe, Gjykata Supreme e pati në konsideratë dhe shqyrtoi rastet e ndryshme mbi të cilat pala e paditur në revizion potencon faktin se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit, me çka për mes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Ndërsa për periudhën e aplikimit të kamatës e cila ishte nga data 16.10.2020, Gjykata Supreme e shqyrtoi aktgjykimin e goditur duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, vërejtji parregullsinë sa i përket Ligjit të aplikueshëm lidhur me kohën e rrjedhjes së kamatëvonesës, çështje e cila nuk ishte ngritur fare as në ankesë e as në revizion. Në zbatim të ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme gjeti se, me qenë se pala paditëse nuk ka atakuar

këtë pjesë me ankesë e as me revizion, Gjykata Supreme e Kosovës, sipas detyrës zyrtare, gjithnjë duke u kujdesur për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, vërejtji pasaktësinë në kohën e rrjedhjes së kamatës e cila sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është caktuar gabimisht nga 16.10.2020, kurse sipas kësaj gjykate pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material (dëmi i zakonshëm apo fitimi i munguar), kamata fillon që të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë (në rastin konkret më 12.04.2013) e deri në pagesën e plotë. Kjo pasaktësi në aplikimin e ligjit material nuk u korrektoa për faktin se vetëm pala e paditur e ka atakuar aktgjykimin, për këto shkaqe ndryshimi do të ishte i dëmshëm për palën që ka parashtruar revizion, andaj ekziston ndalesa reformatio in peius, ashtu siç përshihet në nenin 203 të LPK-së dhe për këtë arsye edhe pse u identifikua si zbatim i gabuar i ligjit, aktgjykimi në këtë pjesë nuk u ndryshua.

Me pretendimet tjera të revizionit nuk mund të vihet në pyetje aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, në pjesën ku refuzohet revizioni nga se këto pretendime të revizionit ishin të përgjithësuara dhe të pa argumentuara, andaj si të tilla u refuzuan si të pabazuara.

Për sa i përket pretendimit të revizionit për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në mbështetje të dispozitës së nenit 214.2 të LPK-së, gjykata, nuk e shqyrtoi, sepse revizioni nuk mund të paraqitet për këtë arsye

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.156/2024 datë 16.04.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami

Numri i lëndës: 2019:177065
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05579460